

LIGJ
Nr.7426, datë 14.11.1990

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.6942, DATË 25.12.1984 “PËR ADMINISTRIMIN,
RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E
MONETARE”**

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.6942, datë 15.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e dytë të nenit 4, pas fjalëve “të biletashitësit” shtohen fjalët “të përgjegjësit të repartit të prodhimit, të lokalit të shërbimit komunal, të artizanatit, të matësit e të kualifikuesit të lëndës drusore...”.

Neni 2

Në nenin 13, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për verifikimin e mallrave të konsumit të gjerë e të prodhimeve farmaceutike, në komision marrin pjesë përfaqësuesi i ndërmarrjes, punonjësit me përgjegjësi materiale dhe kur ka diferenca e mosmarrëveshje, merr pjesë edhe përfaqësuesi i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajonit”.

Neni 3

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

- Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

-“Për vendin e marrjes në dorëzim të mallrave të konsumit të gjerë e të prodhimeve farmaceutike, të disa mallrave të eksportit, si dhe për verifikimin e sasisë, të cilësisë, llojit, qënies së plotë të tyre dhe për markën e prodhimit, zbatohen rregullat e caktuara nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse:

- Në fund të paragrafit të dytë shtohen fjalët “dhe Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar”.

Neni 4

Në nenin 18 pas fjalëve “...kurse inventarizimi...” shtohen fjalët “i bibliotekave”.

Neni 5

Në nenin 24, në shkronjën “ç”, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Mungesat tej normave të firove ligjore dhe prishjet e dëmtimet e vlerave materiale u bëhen ngarkim shkaktarëve dhe, në raste të veçanta kur nuk janë gjetur fajtorët, pasi diskutohen në kolektivin punonjës kalojnë në ngarkim të rezultatit financiar, sipas rregullave që cakton Ministria e Financave”.

Neni 6

Neni 36 ndryshoet si vijon:

“Pagesat me anë të Bankës për mallrat e blera dhe për punimet e shërbimet e kryera, si dhe pagesat për detyrimet e tjera, bëhen me kalimin në llogari, sipas mënyrave që caktohen me dispozita të veçana të Këshillit të Ministrave”.

Neni 7

Në paragrafin e dytë të nenit 48 fjalët “...kurse Ministria e Financave...” zëvendësohen me fjalët “...kurse drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar...”

Neni 8

Në nenin 49, paragrafi i dytë dhe i tretë ndryshohen si vijon:

“Të drejtën e gjobës e kanë përgjegjësi i financës në ndërmarrje, institucione, reparte ushtarake e kooperativa, përgjegjësi i financës dhe i kontroll revizionit në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajont, përgjegjësi i financës dhe i kontroll-revizionit në njësitë e bashkuara ushtarake, drejtori i drejtorisë ose kryetari i degës së financës dhe i kontroll-revizionit në ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe inspektorët e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore e të Komisionit të Kontrollit të Shtetit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht te përgjegjësi i financës e i kontroll revizionit të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajonit dhe të njësisë së bashkuar ushtarake, te kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajonit dhe te ministri ose drejtuesi i institucionit tjetër qendror, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 9

Nenet 33, 34 dhe shkronjat “c” e “f” të nenit 35, shfuqizohen.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA